



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2596/2 prot.

Datë 25.10.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “ECO RICIKLIM”SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-79814-09-13-2023 me objekt “Evadimi dhe trajtimi i mbetjeve spitalore”, me fond limit 14,706,700.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 02.10.2023 nga autoriteti kontraktor Spitali Rajonal Fier.

Ankimues: “ECO RICIKLIM”SHPK me NIPT L61814009B dhe adresë : Pasuria nr.1070, Zona Kadastrale 3965, Metalurgji, Bradashesh, Elbasan.

Autoriteti Kontraktor: Spitali Rajonal Fier
Adresa: Lagja “1Maj” Rruga “Invalidet e Luftes”

Në datën 24.10.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3533 dhe me nr.2596 prot., datë 24.10.2023 e operatorit ekonomik “ECO RICIKLIM”SHPK.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “ECO RICIKLIM”SHPK.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime” Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori

ekonomik “ECO RICIKLIM”SHPK, kundërshton me anë të ankesës me numër ankimi elektronik elektronik A/2023/3533 dhe me nr.2596 prot., datë 24.10.2023.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

“ - Nuk ka paraqitur : Katalog ose skede teknike per kontenitoret : 1- Mbetjet me kodin 18 01 09, Ena mbajtese : kuti te kycura farmaceutike kontinetore te verdhe me shenimin “te rrezikshme farmacia”. Kontenitore special. Te kerkuara Sipas Formulari i Termave te References (tabela). 2-Qese plastike. Te kerkuara sipas Formulari i Specifikimeve Teknike, sipas standarteve dhe kerkesave te specifikimeve Teknike dhe Termave te References. Kriter ky i percaktuar ne Shtojca 8 , “Kriteret e vecanta te kualifikimit” pika 2.3.7.”

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 25.10.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri